



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Zyra e Rregullatorit për Energji

Rregulla për Mekanizmin Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme
(Rregulla për Mekanizmin e BRE)

03 nëntor 2025



Përmbajtja

Kapitulli 1	Dispozitat e Përgjithshme	3
Neni 1	Fushëveprimi dhe Qëllimet	3
Neni 2	Përkufizimet dhe Interpretimet	3
Kapitulli 2	Rolet dhe përgjegjësitë e Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme	5
Neni 3	Menaxhimi dhe operimi i Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme	5
Neni 4	Pala Homologe e Prodhuesve të BRE sipas Skemës Mbështetëse	6
Neni 5	Vetë-konsumatorët e Energjisë së Ripërtërishme	7
Neni 6	Regjistri Publik i Prodhuesve të BRE nën Mbështetje	8
Neni 7	Llogaritë e ndara	9
Kapitulli 3	Fondi Mbështetës i Energjisë së Ripërtërishme	10
Neni 8	Parimet e Përgjithshme	10
Neni 9	Përshtatjet e Rregullta	11
Neni 10	Shqyrtimet e Jashtëzakonshme	11
Neni 11	Shpenzimet e Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme	11
Neni 12	Të ardhurat e Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme	12
Neni 13	Borxhi i Keq i Lejuar	13
Neni 14	Faktori i Rikthimit	13
Neni 15	Likuiditeti i Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme	13
Kapitulli 4	Detyrimi për Energji të Ripërtërishme	14
Neni 16	Tarifa e Detyrimit për Energji të Ripërtërishme	14
Kapitulli 5	Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare	15
Neni 17	Gjuha Zyrtare e Rregullës	15
Neni 18	Ndryshimet në Rregullore	16
Neni 19	Interpretimi	16
Neni 20	Hyrja në fuqi	16
Shtojca 1	Llogaritja e Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme	17
Shtojca 2	Procesi i Përshtatjeve të Rregullta	19
Shtojca 3	Procesi i Rishikimit të Jashtëzakonshëm	20
Shtojca 4	Kompensimi për pagesat e Vetë-konsumatorëve të Energjisë së Ripërtërishme	22



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energjisë, në përputhje me autoritetin e dhënë sipas Nenit 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 25, Nenit 26, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, Nenit 5, paragrafi 3, Nenit 23, paragrafëve 2, 3, 4, 5 dhe 6, Nenit 24, Nenit 26 paragrafi 3 dhe paragrafi 4, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.4 dhe nënparagrafi 2.5 dhe Nenit 30 të Ligjit Nr. 08/L-258 për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Energjisë së Ripërtërishme, miratoi sa vijon:

Rregullën për Mekanizmin Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme (Rregulla mbi Mekanizmin e BRE)

KAPITULLI 1 DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Fushëveprimi dhe Qëllimet

- 1 Kjo Rregull përcakton:
 - 1.1 Rolet dhe përgjegjësitë e Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme, entiteti përgjegjës për menaxhimin dhe operimin e Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme;
 - 1.2 Metodologjinë për përcaktimin e kostos vjetore të Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme (Fondi BRE);
 - 1.3 Metodologjinë për llogaritjen dhe përditësimin periodik të tarifës së Detyrimit për Energjinë e Ripërtërishme (DER), e zbatueshme për të gjithë konsumatorët për të financuar Mbështetjen e Energjisë së Ripërtërishme; dhe,
 - 1.4 Mekanizmin për kompensimin e Furnizuesve për kostot e shkaktuara për zbatimin e skemave mbështetëse për Vetë-konsumatorët e Energjisë së Ripërtërishme.

Neni 2

Përkufizimet dhe Interpretimet

- 1 Termat e mëposhtëm përdoren në këtë Rregullore dhe kanë kuptimet e mëposhtme:
 - 1.1 “Ditët e Punës” do të thotë të gjitha ditët e punës të javës siç përcaktohen në ligjin e Kosovës;
 - 1.2 “Kontrata për Diferencë” do të thotë një lloj mbështetjeje përmes barazimit financiar, ku një premium rrëshqitës, i përbërë nga ndryshimi midis Çmimit Referent dhe Çmimit të Fiksuar, barazohet ndërmjet Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme dhe Prodhuesit BRE nën mbështetje. Nëse Çmimi Referent është më i ulët se Çmimi Fiksuar, Operatori i



Energjisë së Ripërtërishme paguan ndryshimin Prodhuesit BRE nën mbështetje. Nëse Çmimi Referent është më i lartë se Çmimi Fiksuar, Prodhuesi BRE nën Mbështetje i paguan ndryshimin Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme;

- 1.3 “Kontratë për Premium” do të thotë formë e mbështetjes përmes barazimit financiar ku një premium fiks mbi çmimin e tregut paguhet nga Operatori i Energjisë së Ripërtërishme për Prodhuesin e Privilegjuar për energjinë elektrike të prodhuar prej tij;
- 1.4 “Ngjarje e Jashtëzakonshme” do të thotë një ngjarje që shkatohet kur vlera e shpenzimeve të Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme devijon përtej Pragut të Materialitetit;
- 1.5 "Rishikim i Jashtëzakonshëm" ka kuptimin që i është dhënë në Shtojca 3;
- 1.6 “Garanci e Origjinës” do të thotë dokumenti elektronik që vërteton para një konsumatori fundor se një pjesë apo sasi e caktuar e energjisë është prodhuar nga Burime të Ripërtërishme të Energjisë dhe e cila mund të shfrytëzohet për shitje;
- 1.7 "Rezerva e Likuiditetit" ka kuptimin që i është dhënë në Neni 15;
- 1.8 “Operator i Tregut” ose “OT” do të thotë mbajtësi i Licencës së Operatorit të Tregut;
- 1.9 "Pragu i Materialitetit" ka kuptimin që i është dhënë në Neni 10;
- 1.10 “Treg i Organizuar” do të thotë tregu kombëtar i organizuar një-ditë para i energjisë elektrike;
- 1.11 “Marrëveshje e Blerjes së Energjisë” do të thotë një marrëveshje e nënshkruar ndërmjet Ministrisë dhe Prodhuesit BRE sipas Mbështetjes, që përcakton termat dhe kushtet, për ndërtimin e një objekti për prodhimin e energjisë elektrike nga një Prodhues i BRE me Mbështetje;
- 1.12 “Përshtatjet e Rregullt” do të thotë përshtatja mekanike e Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme që ndërmerret drejt fundit të çdo Viti Relevant;
- 1.13 “Rregullator” do të thotë Zyra e Rregullatorit për Energji;
- 1.14 “Viti Përkatës” do të thotë periudha prej 12 muajsh kalendarikë të njëpasnjëshëm midis Përshtatjeve të Rregullta (1 Prill - 31 Mars);
- 1.15 “Tarifa e Detyrimit për Energjinë e Ripërtërishme (DER)” ka kuptimin e dhënë në Neni 16;
- 1.16 “Fondi Mbështetës i Energjisë së Ripërtërishme” është fondi i llogarive të izoluara, i menaxhuar dhe i operuar nga Operatori i Energjisë së Ripërtërishme për mbledhjen dhe shpërndarjen transparente të burimeve financiare për të kompensuar Prodhuesit e Energjisë së Ripërtërishme BRE nën Mbështetje dhe administrimin e Detyrimit të Energjisë së Ripërtërishme në përputhje me Kornizën Mbështetëse të Energjisë së Ripërtërishme;



- 1.17 “Operatori i Energjisë së Ripërtërishme” është subjekti i caktuar për të qenë pale homologe e Prodhuesve të Energjisë së Ripërtërishme që përfitojnë nga Skema Mbështetëse dhe është përgjegjës për menaxhimin e Fondit Mbështetës të për Energjinë e Ripërtërishme;
 - 1.18 “Vetë-konsumator i Energjisë së Ripërtërishme” konsumatori fundor që operon brenda hapësirave të tij, që prodhon energji elektrike të Ripërtërishme për konsum vetanak, i cili mund të ruajë ose shesë energji elektrike të Ripërtërishme të prodhuar nga vetë ai, me kusht që, për një Vetë-konsumator të Burimeve të Ripërtërishme jo-familjar, këto veprimtari nuk përbëjnë veprimtarinë e tij kryesore tregtare ose profesionale;
 - 1.19 “Prodhues BRE nën Mbështetje” do të thotë çdo Prodhues i Energjisë së Ripërtërishme që përfiton nga një Skemë Mbështetjeje sipas dispozitave të Ligjit;
 - 1.20 “Kontratë për Mbështetje” do të thotë kontrata në bazë të së cilës Prodhuesit BRE nën Mbështetje i jepet mbështetje sipas Skemës së Mbështetjes, qoftë në një Marrëveshje për Blerje të Energjisë/MBE, në një Kontratë për Premium ose në një Kontratë për Diferencë;
 - 1.21 “Skema Mbështetëse” ka kuptimin e dhënë në Ligjin për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë Nr. 08/L-258 dhe çdo skemë tjetër mbështetëse të përcaktuar me ligj.
- 2 Termat e tjera në këtë rregull do të kenë kuptimet e specifikuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë ose në Ligjin për Energjinë.

KAPITULLI 2 ROLET DHE PËRGJEGJËSITË E OPERATORIT TË ENERGJISË SË RIPËRTËRISHME

Neni 3

Menaxhimi dhe operimi i Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme

- 1 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme do të menaxhojë dhe operojë Fondin Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme, në përputhje me këtë Rregull dhe udhëzimet e dhëna nga Rregullatori.
- 2 Fondi Mbështetës i Energjisë së Ripërtërishme siguron që mbledhja, shpërndarja dhe përdorimi fondeve të OER realizohet duke përfshirë:
 - 2.1 diferenat e pagueshme midis Çmimit të Fiksuar dhe Çmimit Referent për Prodhuesit e Privilegjuar me mbështetje bazuar në një Kontratë për Diferencë dhe pagesat e premiumit për Prodhuesit e Privilegjuar me mbështetje në bazë të një Kontrate për Premium;



- 2.2 diferencat e pagueshme midis Çmimit të Fiksuar dhe Çmimit Referent për Prodhuesit e Privilegjuar me mbështetje bazuar në një Tarifë Nxitëse (*Feed-in*) bazuar në një Marrëveshje për Blerjen e Energjisë;
- 2.3 kostot për mbulimin e jobalanceve për Prodhuesit BRE nën Mbështetje që janë pjesërisht të përjashtuar nga përgjegjësia e balancimit, duke përfshirë Vetë-Konsumatorët e Energjisë së Ripërtërishme;
- 2.4 Kostot që lidhen me kompensimin e furnizuesve për zbatimin e skemave mbështetëse të energjisë së ripërtërishme për Vetë-Konsumatorë e Energjisë së Ripërtërishme; dhe,
- 2.5 kostot e përditshme operative dhe të mirëmbajtjes të Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme, duke përfshirë, por pa u kufizuar në koston e financimit, qasjen në treg, kapitalin punues dhe koston e rezervave të provizionit për të siguruar likuiditetin financiar dhe aftësinë paguese të Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme në mënyrë të vazhdueshme.
- 2.6 Rregullatori me vendim përcakton përgjegjësitë e Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme.

Neni 4

Pala Homologe e Prodhuesve të BRE sipas Skemës Mbështetëse

- 1 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme do të menaxhojë pagesat financiare për BRE që përfitojnë nga Skema Mbështetëse, siç është Kontrata për Diferencë, Kontrata për Premium ose Marrëveshja për Blerje të Energjisë (MBE).
- 2 Në cilësinë e palës homologe kontraktuale, Operatori i Energjisë së Ripërtërishme trashëgon Marrëveshjet e Blerjes së Energjisë të lidhura para hyrjes në fuqi të Ligjit për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Energjisë së Ripërtërishme.
- 3 Në këtë proces, sigurohet që transferimi i detyrimeve dhe të drejtave të këtyre marrëveshjeve të bëhet pa krijuar konflikt me marrëveshjet ekzistuese, përmes dispozitave tranzitore që përcaktojnë qartë bartjen e përgjegjësiave ligjore dhe financiare.
- 4 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme duhet:
 - 4.1 të jetë marrësi fizik i energjisë elektrike të prodhuar nga Prodhuesit BRE nën Mbështetje, të cilëve u jepet mbështetje bazuar në një Marrëveshje për Blerje të Energjisë;
 - 4.2 të jetë palë homologe kontraktuale për Prodhuesit e Energjisë BRE sipas Mbështetjes, për shlyerjen e pagesave sipas Kontratës së Mbështetjes.
- 5 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme duhet ta shesë energjinë elektrike të blerë sipas MBE që nuk kanë një klauzolë konvertimi në një Kontratë për Diferencë drejtpërdrejt në Tregun e Organizuar.



- 6 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme do të shesë Garancitë e Origjinës të lëshuara në lidhje me energjinë elektrike nga Prodhuesit e Burimeve të Ripërtërishme nën Mbështetje dhe do të transferojë të ardhurat nga këto shitje në Fondin Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme.
- 7 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme duhet të publikojë në mënyrë periodike, një herë në vit, një raport të detajuar mbi performancën financiare dhe tregtare të operimeve sipas këtij neni, përfshirë të ardhurat nga shitjet e energjisë dhe Garancive të Origjinës, kostot e barazimit dhe kompensimet e paguara ndaj Prodhuesve të Energjisë së Ripërtërishme.

Neni 5

Vetë-konsumatorët e Energjisë së Ripërtërishme

- 1 Vetë-konsumatorët e Energjisë së Ripërtërishme me skema mbështetëse duhet të marrin pjesë në grupin balancues të Furnizuesit të tyre për energjinë elektrike të tërhequr nga rrjeti. Ndërsa për energjinë elektrike të tepërt të futur në rrjet, duhet të marrin pjesë në grupin balancues të Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme.
 - 1.1 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme është Pala Përgjegjëse Balancuese për të gjithë energjinë elektrike të futur në rrjet nga Vetë-konsumatorët e Energjisë së Ripërtërishme që marrin pjesë në skemat mbështetëse për Vetë-konsumimin e Energjisë së Ripërtërishme, dhe duhet të paraqesë nominime dhe përditësime në përputhje me Rregullat e Tregut.
 - 1.2 Çdo Furnizues mbetet Pala Përgjegjëse Balancuese për konsumin e klientëve të tij dhe do të vazhdojë të nominojë ngarkesën.
- 2 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme do të grumbullojë dhe shesë energjinë e tepërt në Tregun e Organizuar.
 - 2.1 Gjatë injektimit dhe për çdo periudhë shlyerje, pronësia e energjisë elektrike të tepërt nga Vetë-konsumatorët e Energjisë së Ripërtërishme i transferohet Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme.
 - 2.2 Garancitë e Origjinës për energjinë elektrike të tepërt do të lëshohen dhe do të jenë në pronësi të Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme.
 - 2.3 Energjia elektrike e vetë-konsumuar pas matësit nuk transferohet në pronësi.
 - 2.4 Të gjitha të ardhurat dhe kostot nga tregtimi dhe barazimi i jobalancave për energjinë elektrike të furnizuar nga Vetë-Konsumatorët e Energjisë së Ripërtërishme me skema mbështetëse i shtohen dhe barazohen nga Operatori i Energjisë së Ripërtërishme.
- 3 Operatori i rrjetit duhet të sigurojë Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme dhe Furnizuesve përkatës matje të validuara të konsumit dhe energjisë së tepërt për intervale.



- 4 Çdo Furnizues duhet të mbajë regjistra të veçantë llogarish për secilin prej Vetë-Konsumatorëve të Energjisë së Ripërtërishme.
 - 4.1 Regjistri i llogarive për Vetë-konsumatorët e Energjisë së Ripërtërishme të mbështetur përmes skemës së matjes neto duhet të regjistrojë të gjitha kreditë e fituara dhe të përdorura, si dhe bilancin mujor të kredive për një Vetë-konsumator të Energjisë së Ripërtërishme në kWh.
 - 4.2 Regjistri i llogarive për Vetë-konsumatorët e Energjisë së Ripërtërishme të mbështetur përmes skemës së faturimit neto duhet të regjistrojë të gjitha kreditë e fituara dhe të përdorura, si dhe bilancin mujor të kredive për një Vetë-konsumator të Energjisë së Ripërtërishme në euro.
 - 4.3 Çdo Furnizues duhet të dorëzojë Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme një deklaratë elektronike mujore, në një format të miratuar nga Rregullatori, që tregon për çdo Vetë-Konsumator të Energjisë së Ripërtërishme: llojin e skemës, energjinë elektrike të tepërt (në kWh), koeficientët e aplikuar, komponentën e çmimit të furnizimit me energji (për faturimin neto), çmimin mesatar me pakicë (për matjen neto), kreditë e dhëna (në euro për faturimin neto/në kWh për matjen neto), kreditë e shpenzuara dhe kreditë e mbetura.
- 5 Në rast të ndryshimit të Furnizuesit, Furnizuesi i mëparshëm duhet të transferojë Furnizuesit të ri të gjitha bilancet e papaguara të librit të kontabilitetit dhe transferimet e kreditit sipas Periudhës Tarifore në një format transferimi të miratuar nga rregullatori.
 - 5.1 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme duhet të barazojë bilancet e transferuara me të dhënat e matjes së rrjetit për të parandaluar pagesën e dyfishtë.
 - 5.2 Titulli i energjisë elektrike të tepërt vazhdon të transferohet Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme pa ndërprerje.
- 6 Furnizuesit duhet të kompensojnë Vetë-konsumatorët e Energjisë së Ripërtërishme sipas rregullave të skemës mbështetëse.
- 7 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme do të kompensojë furnizuesit në baza mujore, bazuar në kreditë e shpenzuara të Vetë-konsumatorëve të Energjisë së tyre sipas Shtojca 4.

Neni 6

Regjistri Publik i Prodhuesve të BRE nën Mbështetje

- 1 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme duhet të mbajë një regjistër elektronik të të gjithë Prodhuesve të Energjisë së Ripërtërishme nën Mbështetje, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- 2 Regjistri duhet të përfshijë të paktën informatat e mëposhtme:
 - 2.1 Emri i prodhuesit, vendndodhjen, kapacitetin dhe teknologjinë e impiantit;



- 2.2 Formën, nivelin dhe kohëzgjatjen e mbështetjes;
 - 2.3 datën e hyrjes dhe daljes nga Skema Mbështetëse;
 - 2.4 nivelin e çmimit të mbështetjes ose formulën për llogaritjen e tij;
 - 2.5 statusin e projektit (aktiv, në pezullim, përjashtuar);
 - 2.6 operatorin e rrjetit ku është i lidhur impianti; dhe
 - 2.7 numrin unik të identifikimit të kontratës së mbështetjes.
- 3 Regjistri do të jetë i qasshëm për publikun dhe do të përditësohet periodikisht për të pasqyruar çdo pranim ose përjashtim të ri nga Skema Mbështetëse.

Neni 7

Llogaritë e ndara

- 1 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme duhet të mbajë llogari, të dhëna dhe pasqyra financiare të ndara për Fondin mbështetës nga ato të Operatorit të Tregut, në një mënyrë ekuivalente me atë që kërkohet nga ndërmarrjet e ndara, edhe nëse të dy subjektet janë nën pronësi ose menaxhim të përbashkët.
- 2 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme duhet të zbatojë metoda të përshtatshme për ndarje të llogarive për të siguruar që:
 - 2.1 Të mos ndodh ndonjë ndër-subvencionim midis Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme dhe Operatorit të Tregut;
 - 2.2 Informacioni i ndjeshëm komercial i marrë nga Operatori i Energjisë së Ripërtërishme gjatë operacioneve të tij të mos shkëmbehet me Operatorin e Tregut, përveç rasteve kur kërkohet për Operatorin e Tregut në ekzekutimin e mandatit të tij;
 - 2.3 Burimet financiare, detyrimet ose garancitë e Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme të jenë të ndara nga ato të Operatorit të Tregut.
- 3 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme duhet të propozojë faktorët e ndarjes së kostove për kostot e përbashkëta midis Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme dhe Operatorit të Tregut, brenda 90 ditëve nga miratimi i këtij Rregulli.
- 4 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme do të përgatisë çdo vit një raport financiar audituar të konsoliduar për Fondin e Mbështetjes, që përfshin të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e ndara sipas burimeve dhe destinacioneve të përdorimit.
- 5 Raporti dorëzohet Rregullatorit dhe publikohet në format përmbledhës në faqen zyrtare të Operatorit.



KAPITULLI 3 FONDI MBËSHTETËS I ENERGJISË SË RIPËRTËRISHME

Neni 8

Parimet e Përgjithshme

- 1 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme duhet të përcaktojë Tarifat e Detyrimit të Energjisë së Ripërtërishme në mënyrë të tillë që, brenda çdo Viti Relevant, të ardhurat që pret të fitojë nga tarifa të jenë të barabarta me Fondin Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme të miratuar nga Rregullatori.
- 2 Fondi BRE administrohet në mënyrë transparente, objektive dhe të paanshme nga Operatori i Energjisë së Ripërtërishme, nën mbikëqyrjen e Rregullatorit.
- 3 Mjetet financiare të Fondit përdoren vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë Rregull, në përputhje me Kornizën Mbështetëse dhe buxhetin e miratuar nga Rregullatori.
- 4 Fondi Mbështetës për Energjinë e Ripërtërishme do të përcaktohet gjatë Përshtatjeve të Rregullta si më poshtë:
 - 4.1 Para çdo Viti Relevant, Operatori i Energjisë së Ripërtërishme duhet të propozojë Rregullatorit koston e Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme dhe Tarifën e Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme;
 - 4.2 Kostoja e Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme të propozuar nga Operatori i Energjisë së Ripërtërishme llogaritet bazuar në koston e mbështetjes për Vitin Relevant të ardhshëm dhe ndryshimet në mbi/nën-vlerësimin e të ardhurave për Vitin Relevant të mëparshëm;
 - 4.3 Tarifa e Detyrimit për Energjinë e Ripërtërishme e miratuar nga rregullatori do të mbetet fikse për kohëzgjatjen e Vitit Relevant, përveç rasteve kur ndodh një Ngjarje të Jashtëzakonshme (Neni 10);
 - 4.4 Vlerësime të Jashtëzakonshme (Neni 10), të cilat përfshijnë një rregullim të Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme dhe Tarifës së Detyrimit të Energjisë së Ripërtërishme për ndryshimet materiale të shkaktuara nga një Ngjarje e Jashtëzakonshme, do të ndërmerren sipas nevojës.
- 5 Të gjitha fondet e mbledhura në kuadër të Fondit të Mbështetjes për BRE ruhen në një llogari të veçantë bankare dhe mund të përdoren vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë Rregull.



Neni 9

Përshtatjet e Rregullta

- 1 Fondi Mbështetës i Energjisë së Ripërtërishme dhe Tarifat e Detyrimit të Energjisë së Ripërtërishme do të përcaktohen gjatë Përshtatjeve të Rregullta.
- 2 Përshtatjet e Rregullta do të mbahet para çdo Viti Relevant të ardhshëm.
- 3 Përshtatja përfshin verifikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve faktike të Fondit BRE, krahasuar me parashikimet fillestare, si dhe llogaritjen e teprcës apo mungesës së mjeteve financiare.
- 4 Ndryshimi në Fondin Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme dhe Tarifat e Detyrimit të Energjisë së Ripërtërishme në çdo Përshtatje të Rregullt duhet të marrë në konsideratë shpenzimet dhe të ardhurat e parashikuara të fondit BRE dhe Faktorin e Rikthimit.
- 5 Formulatat për llogaritjen e Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme në Përshtatjet e Rregullta janë paraqitur në Shtojca 1.
- 6 Procedura dhe afati kohor për zbatimin e Përshtatjeve të Rregullta janë paraqitur në Shtojca 2.

Neni 10

Shqyrtimet e Jashtëzakonshme

- 1 Shqyrtimet e Jashtëzakonshme do të ndërmerren në rast të Ngjarjeve të Jashtëzakonshme, siç përcaktohet në Shtojca 3.
- 2 Në Shqyrtimet e Jashtëzakonshme do të llogaritet ndikimi i Ngjarjes së Jashtëzakonshme në Fondin Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme për pjesën e mbetur të Vitit Relevant.
- 3 Përshtatja e Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme do të bëhet nëse rezultati i Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm është më i madh se Pragu i Materialitetit.
- 4 Pragu i Materialitetit do të vendoset në 20%, përveç nëse përcaktohet ndryshe gjatë Përshtatjeve të Rregullta bazuar në një propozim nga Operatori i Energjisë së Ripërtërishme dhe të miratuar nga Rregullatori.
- 5 Procedura dhe afati kohor për zbatimin e Shqyrtimeve të Jashtëzakonshme janë dhënë në Shtojca 3.

Neni 11

Shpenzimet e Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme

- 1 Parashikimi i Shpenzimeve të Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme do të përfshijë:



- 1.1 Kostot operative dhe të mirëmbajtjes, duke përfshirë kostot administrative, auditimit dhe të raportimit;
- 1.2 Kostot e nevojshme për të mbuluar energjinë elektrike të blerë nga Prodhuesit BRE nën Mbështetje;
- 1.3 Kostot e nevojshme për të mbuluar mbështetjen e ofruar sipas kornizave të Kontratave për Diferencë (CfD);
- 1.4 Kostot e nevojshme për të mbuluar mbështetjen e ofruar sipas kornizave të Kontratës për Premium (CfP);
- 1.5 Kostot që lidhen me reduktimet që i nënshtrohen kompensimit nga Operatori i Energjisë së Ripërtërishme për Prodhuesit BRE nën Mbështetje.
- 1.6 Kostot e nevojshme për të mbuluar mbështetjen e ofruar për Vetë-konsumatorët e Energjisë së Ripërtërishme sipas kornizave të matjes neto dhe faturimit neto;
- 1.7 Kostot balancuese për Prodhuesit BRE nën Mbështetje që janë pjesërisht të përjashtuar nga përgjegjësia balancuese;
- 1.8 Kostot financiare që lidhen me sigurimin e likuiditetit të fondit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në koston e financimit, qasjen në treg, kapitalin qarkullues, koston e rezervave të provizionimit për të siguruar likuiditetin financiar dhe aftësinë paguese të Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme në mënyrë të vazhdueshme, duke marrë parasysh edhe sezonalitetin e fondeve;
- 1.9 Kostot që lidhen me financimin e çdo kostoje shtesë të skemës mbështetëse të Energjisë së Ripërtërishme që parashihet të financohet përmes Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme.

Neni 12

Të ardhurat e Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme

- 1 Burimet e të ardhurave të Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme përfshijnë:
 - 1.1 Të ardhurat nga shitjet e energjisë elektrike të blera nga Prodhuesit e Energjisë së Ripërtërishme (BRE) nën Mbështetje, të cilët janë mbështetur bazuar në një Tarifë nxitëse (Feed-in), PPA ose energji elektrike të blerë përmes Skemës Mbështetëse të Vetë-Konsumatorëve të Energjisë së Ripërtërishme në Tregun e Organizuar;
 - 1.2 Të ardhurat nga shitjet e Garancive të Origjinës përmes tregjeve të organizuara të GO-së, ose në mungesë të tregjeve të tilla, përmes një procedure konkurruese të propozuar nga Operatori i Energjisë së Ripërtërishme dhe të miratuar nga Rregullatori;
 - 1.3 Të ardhura nga grantet, donacionet dhe kontributet.



- 2 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme do të sigurojë që shitja e Garancive të Origjinës të kryhet në mënyrë transparente dhe konkurruese përmes një procedure të hapur të miratuar nga Rregullatori.
- 3 Çmimet mesatare të shitjes, vëllimi dhe të ardhurat e realizuara nga shitja e GO-ve do të publikohen në faqen zyrtare të Operatorit.

Neni 13

Borxhi i Keq i Lejuar

- 1 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme do të lejohet të rikuperojë nivele të arsyeshme të borxhit të keq si një rritje të kostos të Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme.
- 2 Përqindja e borxhit të keq të lejuar do të propozohet nga Operatori i Energjisë së Ripërtërishme dhe do të miratohet nga Rregullatori gjatë çdo Përshtatjeje të Rregullt.

Neni 14

Faktori i Rikthimit

- 1 Faktori i Rikthimit të Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme do të rikthejë nën-ose mbi-vlerësimin e Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme, për shkak të ndryshimeve midis vëllimeve të parashikuara dhe atyre aktuale të energjisë elektrike të transmetuar, çmimeve në Tregun e Organizuar, niveleve të Prodhimit ose çdo ndryshimi tjetër që ndodh për arsye jashtë kontrollit të Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme.
- 2 Çdo rregullim për mbi-ose nën-vlerësim të të ardhurave në vitin e kaluar do të kompensohet me interes, të llogaritur bazuar në EURIBOR plus S%, ku S është një vlerë që do të përcaktohet nga Rregullatori në çdo Përshtatje të Rregullt dhe që pasqyron premiumin e pagueshëm nga licencuesi për kreditë afatshkurtra.

Neni 15

Likuiditeti i Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme

- 1 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme duhet të sigurojë që të ruhet likuiditeti i mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e pagesës ndaj Prodhuesve të Energjisë së Ripërtërishme nën Mbështetje.
- 2 Për të siguruar likuiditetin, Operatori i Energjisë së Ripërtërishme duhet të mbulojë koston e marrjes së linjave të kreditit afatshkurtër ose instrumenteve të tjera të financimit.
- 3 Në rast se Operatori i Energjisë së Ripërtërishme, duke vepruar në cilësinë e tij si administrator i Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme, nuk është në gjendje të sigurojë financim afatshkurtër me kushte të arsyeshme tregu sipas paragrafit 1 të këtij neni, Rregullatori duhet të përcaktojë Rezerve Likuiditeti brenda Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme.



- 4 Rezerva e Likuiditetit do të korrespondojë me një nivel që mundëson mbulimin e së paku nëntë (9) pagesave mujore mesatare të parashikuara të Fondit për Vitin e ardhshëm Relevant dhe do të përditësohet periodikisht gjatë çdo Përshtatjeje të Rregullt.
- 5 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme duhet të sigurojë që kostoja e linjave të kreditit afatshkurtër dhe instrumenteve të tjera të financimit të reflektojë normat efikase të interesit dhe kushtet aktuale të tregut.
- 6 Rezerva e Likuiditetit do të përbëhet nga rezerva parash të akumuluar nëpërmjet mbi-pagesës së Detyrimit të Energjisë së Ripërtërishme ose burimeve të tjera të miratuara, në një shumë të mjaftueshme për të siguruar shlyerjen e vazhdueshme dhe në kohë të detyrimeve ndaj prodhuesve të energjisë së Ripërtërishme.
- 7 Madhësia e Rezervës së Likuiditetit i nënshtrohet miratimit paraprak nga Rregullatori, duke marrë parasysh:
 - 7.1 profilin e rrjedhës së parave të pritura të Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme; dhe,
 - 7.2 detyrimet e pagesës sipas skemës së mbështetjes së energjisë së Ripërtërishme.
- 8 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme duhet të raportojë çdo vit te Rregullatori mbi nivelin e rezervës së likuiditetit, shfrytëzimin dhe rimbushjen e tij.

KAPITULLI 4 DETYRIMI PËR ENERGJI TË RIPËRTËRISHME

Neni 16

Tarifa e Detyrimit për Energji të Ripërtërishme

- 1 Tarifa e Detyrimit për Energji të Ripërtërishme zbatohet për të gjithë konsumatorët e lidhur në sistemin e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike në Kosovë, përveç konsumatorëve që përjashtohen nga pagesa, sipas paragrafit 4 të këtij Neni.
- 2 Fondi BRE do të financohet përmes Tarifës së Detyrimit të Energjisë së Ripërtërishme, i cili mblidhet nga të gjithë furnizuesit që furnizojnë konsumatorët fundorë, në baza mujore, llogaritur për kWh të konsumuar.
- 3 Mbledhja e Tarifës së Detyrimit për Energji të Ripërtërishme nga furnizuesit realizohet në përputhje me dispozitat e Ligjit për Energjinë Elektrike dhe aktet nënligjore të Rregullatorit.
- 4 Konsumatori fundor mund të përjashtohet nga pagesa e Tarifës së Detyrimit të Energjisë së Ripërtërishme nëse plotësohen të dy kushtet e mëposhtme:
 - 4.1 ka blerë Garanci Origjine që mbulojnë të gjithë konsumin e saj; dhe,



- 4.2 Konsumi i tij furnizohet përmes një kontrate blerjeje me një Prodhues të Energjisë nga BRE i cili nuk merr mbështetje.
- 5 Përrjashtimi nga tarifa realizohet vetëm pasi konsumatori dhe furnizuesi paraqesin prova të dokumentuara dhe të verifikueshme të blerjes së Garancive të Origjinës dhe të kontratës me BRE pa mbështetje.
 - 6 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme duhet të verifikojë saktësinë e dokumenteve para llogaritjes së tarifës.
 - 7 Kërkesa e përjashtuar do të zbritet nga vëllimi total i konsumit të energjisë elektrike, i cili do të shërbejë si bazë për llogaritjen e Tarifës së Detyrimit të Energjisë së Ripërtërishme.
 - 8 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme duhet të u kërkojë të gjithë furnizuesve të ofrojnë instrumente të përshtatshme të sigurimit të pagesës, të cilat do të aktivizohen në rast se furnizuesi nuk i përmbush detyrimet e tij të pagesës.
 - 9 Instrumenti i sigurimit të pagesës do të lëshohet në favor të Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme si përfitues i vetëm dhe do të sigurojë pagesën e duhur dhe në kohë të një shume jo më të vogël se vlera kumulative e tre (3) muajve të pagesave të parashikuara të Tarifës së Detyrimit të Energjisë së Ripërtërishme nga furnizuesi.
 - 10 Tarifa e Detyrimit për Energji të Ripërtërishme do të identifikohet veçmas në faturat/pagesat e konsumatorëve fundorë.
 - 11 Tarifa e Detyrimit për Energjinë e Ripërtërishme do të ketë një vlerë pozitive ose negative në varësi të bilancit të parashikuar të Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme, përveç nëse përcaktohet ndryshe nga Rregullatori në interes të rritjes së likuiditetit të Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme.
 - 12 Tarifa e Detyrimit për Energji të Ripërtërishme do të shfaqet qartë në faturat e konsumatorëve fundorë. Në rast të vlerës negative, Operatori do të aplikojë procedurën e riimbursimit ose zbritjes sipas udhëzimeve të Rregullatorit.

KAPITULLI 5 DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 17

Gjuha Zyrtare e Rregullës

Kjo Rregull është hartuar në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjeve mes versioneve do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.



Neni 18

Ndryshimet në Rregullore

- 1 ZRRE-ja mund të ndryshojë ose modifikojë çdo dispozitë të kësaj Rregulle.
- 2 Procedurat për ndryshimin ose modifikimin e kësaj Rregulle do të jenë të njëjta me ato për miratimin e saj.

Neni 19

Interpretimi

Nëse ka paqartësi në lidhje me dispozitat e kësaj Rregulle, Bordi do të lëshojë informacion shpjegues.

Neni 20

Hyrja në fuqi

Kjo Rregull hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Gani Bucaj, Anëtar

Lutfije Dervishi, Anëtare

Arta Qorolli-Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar



SHTOJCA 1 LLOGARITJA E FONDIT MBËSHTETËS TË ENERGJISË SË RIPËRTËRISHME

- 1 Kjo shtojcë përcakton formulat për llogaritjen e Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme të Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme. Kjo shtojcë synon të plotësojë dhe sqarojë zbatimin e parimeve të përcaktuara në pjesën kryesore të Rregullës.
- 2 Fondi Mbështetës i Energjisë së Ripërtërishme (RESF) do të llogaritet në Përshtatjet e Rregullta duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$RESF = \frac{(C_{PPA} \pm C_{CFD} + C_{FiP} + C_{Pro} + Bal + Adm + Fin - S_{Elec} - S_{GO} - G + Adj)}{(1 - BDTA)}$$

Ku:

C_{PPA}	është kostoja totale e energjisë elektrike të blerë nga Prodhuesit BRE sipas Skemave Mbështetëse. Këto kosto përfshijnë çdo kosto për kompensim që lidhet me reduktimet që i nënshtrohen kompensimit nga Operatori i Energjisë së Ripërtërishme.
C_{CFD}	Diferencat e pagueshme midis Çmimit të Fiksuar dhe Çmimit Referent për Prodhuesit BRE me mbështetje bazuar në një Kontratë për Diferencë (CfD). Këto kosto mund të jenë negative. Këto kosto përfshijnë çdo kosto për kompensim që lidhet me reduktimet që i nënshtrohen kompensimit nga Operatori i Energjisë së Ripërtërishme.
C_{FiP}	Pagesat e premiumit për Prodhuesit BRE me mbështetje në bazë të një Kontrate për Premium. Këto kosto përfshijnë çdo kosto për kompensim që lidhet me reduktimet që i nënshtrohen kompensimit nga Operatori i Energjisë së Ripërtërishme.
C_{Pro}	Kompensimi ndaj Furnizuesit për pagesat ndaj Vetë-Konsumatorë të Energjisë së Ripërtërishme, sipas Skemës Mbështetëse të Vetë-konsumatorëve të Energjisë së Ripërtërishme, të sqaruar në Shtojca 4.
Bal	Kostot e balancimit për prodhuesit BRE-ve nën Mbështetje që janë pjesërisht të përjashtuar nga përgjegjësia e balancimit.
Adm	Kostot administrative, monitoruese dhe raportuese.
Fin	Kostot financiare që lidhen me sigurimin e likuiditetit të fondit, duke përfshirë por pa u kufizuar në kostot e financimit, qasjen në treg, kapitalin punues, koston e sigurimit të rezervave për të garantuar likuiditet financiar dhe aftësinë paguese të Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme në baza të vazhdueshme, duke marrë parasysh edhe sezonalitetin e fondeve.



S_{Elec}	Të ardhurat nga shitjet e energjisë elektrike të blerë nga Prodhuesit e Energjisë së Ripërtërishme (BRE) nën Mbështetje, që janë mbështetur në bazë të një Tarife Nxitëse, MBE ose energji elektrike të blerë përmes Skemës Mbështetëse të Vetë-konsumatorëve të Energjisë së Ripërtërishme, në Tregun e Organizuar.
S_{GO}	Të ardhurat nga shitjet e Garancive të Origjinës. Operatori i Energjisë së Ripërtërishme do të shesë Garancitë e Origjinës përmes tregjeve të organizuara GO, ose në mungesë të tregjeve të tilla, përmes një procesi konkurrues të tenderit që do të propozohet nga Operatori i Energjisë së Ripërtërishme dhe do të miratohet nga ZRRE-ja.
G	Të ardhura nga grantet, donacionet dhe kontributet.
BDTA	Rritja për borxhin e keq për të lejuar dështimet në normat e mbledhjes së borxheve.
3	Përshtatjet e fondit llogariten gjatë çdo rishikimi të tarifave me formulën e mëposhtme: $ADJ = (AAC_{RESF,t-1} - AAR_{RESF,t-1}) * (1 + I_t)$
$AAC_{RESF,t-1}$	Kostot e Realizuara të Lejuara të fondit të BRE gjatë periudhës së mëparshme rregullatore.
$AAR_{RESF,t-1}$	Të Ardhurat e Realizuara të Lejuara (përfshirë të ardhurat nga Obligimi i Energjisë së Ripërtërishme) të fondit BRE gjatë periudhës së mëparshme rregullatore.
I_t	norma e interesit për Vitin Relevant t e llogaritur bazuar në EURIBOR plus S%, ku S është një vlerë që do të përcaktohet nga Rregullatori në çdo Vit Relevant dhe që pasqyron premiumin e pagueshëm nga licencuesi për kreditë afatshkurtra.



SHTOJCA 2 PROCESI I PËRSHTATJEVE TË RREGULLTA

- 1 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme duhet të paraqesë rek Rregullatori Fondin e Mbështetjes së Energjisë së Ripërtërishme të propozuar për Vitin e ardhshëm Relevant të paktën 60 ditë pune para fillimit të Vitit të ardhshëm Relevant.
- 2 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme duhet të përfshijë gjithashtu në dorëzimin e tij të gjitha dokumentet dhe provat përkatëse, duke përfshirë vlerat që lidhen me të gjithë përbërësit e formulave të Rregullta të dhëna në Shtojca 1 dhe çdo dokument tjetër të njoftuar nga Rregullatori.
- 3 Rregullatori mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme që Operatori i Energjisë së Ripërtërishme të shpjegojë më tej metodën e tij të llogaritjes të Fondit të Mbështetjes të Energjisë së Ripërtërishme të propozuar, dhe nëse kërkohet, Operatori i Energjisë së Ripërtërishme duhet të ofrojë menjëherë Rregullatorit çdo informacion ose shpjegim të mëtejshëm të kërkuar.
- 4 Rregullatori duhet të njoftojë Operatorin e Energjisë së Ripërtërishme të paktën 50 ditë pune para fillimit të Vitit Relevant të ardhshëm nëse informacioni i kërkuar nga Rregullatori për të verifikuar llogaritjen e Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme është paraqitur siç duhet.
- 5 Nëse Rregullatori konstaton se informacioni është paraqitur siç duhet, ai do ta publikojë Fondin e Mbështetjes së Energjisë së Ripërtërishme të propozuar për konsultim publik të paktën 40 ditë pune para fillimit të Vitit Relevant të ardhshëm.
- 6 Nëse Rregullatori nuk e pranon propozimin e Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme, duhet të ofrojë arsye dhe dëshmi për mospranim, në përputhje me këtë Rregull, dhe të publikojë llogaritjen e vet të Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme.
- 7 Rregullatori duhet të miratojë Fondin e ri Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme dhe Detyrimin për Energjinë e Ripërtërishme të paktën 10 Ditë Pune para fillimit të Vitit të ardhshëm Relevant.
- 8 Çdo ndryshim në të ardhura që pason nga llogaritjet e pasakta, raportimi i gabuar i të Ardhurave të Rregulluara Aktuale ose mosmarrëveshjet që lidhen me Përshtatjen e Rregullt do të rikuperohet në Vitet Relevante pasuese.
- 9 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme mund të kundërshtojë ose të apelojë çdo vendim të Rregullatorit në përputhje me legjislacionin në fuqi.



SHTOJCA 3 PROCESI I RISHIKIMIT TË JASHTËZAKONSHËM

- 1 Në rast të një Ngjarje e Jashtëzakonshme, Operatori i Energjisë së Ripërtërishme mund të kërkojë një Shqyrtim të Jashtëzakonshëm.
- 2 Shqyrtimi i Jashtëzakonshëm mund të lidhet me më shumë se një Ngjarje të Jashtëzakonshme, në të cilin rast kjo shtojcë trajton efektin financiar kumulativ të këtyre ngjarjeve.
- 3 Brenda 20 Ditëve Pune nga kërkesa e Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm, ai duhet të paraqesë Rregullatorit një Deklaratë të Ndikimit Financiar që përfshin çështjet e mëposhtme:
 - 3.1 Përshkrimin e Ngjarjes së Jashtëzakonshme që është arsyeja për kërkesën e Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm;
 - 3.2 Përmbledhjen e ndikimit të Ngjarjes së Jashtëzakonshme në Fondin Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme;
 - 3.3 Vlerësimin e ndryshimit në kostot e Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme në çdo muaj nga data kur ndodhi (ose filloi) Ngjarja e Jashtëzakonshme deri në fund të Vitit Relevant aktual;
 - 3.4 Vlerësimin e ndryshimit në Fondin e Mbështetjes së Energjisë së Ripërtërishme të parashikuar që rezulton nga Ngjarja e Jashtëzakonshme, në çdo muaj nga data kur ndodhi (ose filloi) Ngjarja e Jashtëzakonshme deri në fund të Vitit Relevant aktual;
 - 3.5 Llogaritjen nëse ndikimi financiar pritet të jetë më i madh se Pragu i Materialitetit i shumëzuar me të ardhurat e marra nga Fondi Mbështetës i Energjisë së Ripërtërishme (në vitin para Ngjarjes së Jashtëzakonshme).
- 4 Nëse Operatori i Energjisë së Ripërtërishme përcakton se ndikimi financiar është më i madh se Pragu i Materialitetit, ai duhet të përfshijë në Raportin e tij të Ndikimit Financiar një Rregullim të Jashtëzakonshëm të propozuar për Fondin Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme.
- 5 Rregullatori mund të nisë gjithashtu një Shqyrtim të Jashtëzakonshëm pa kërkesën e Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme. Nëse po, Rregullatori duhet të njoftojë Operatorin e Energjisë së Ripërtërishme dhe të përfshijë një përshkrim të Ngjarjes së Jashtëzakonshme si dhe një përmbledhje të ndikimit të saj të pritur. Më pas, Operatori i Energjisë së Ripërtërishme duhet të përgatisë një Raport të Ndikimit Financiar sipas procesit të përshkruar më sipër.
- 6 Rregullatori mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme që Operatori i Energjisë së Ripërtërishme të shpjegojë më tej metodën e tij të llogaritjes së Raportit të Ndikimit Financiar dhe Përshtatjes së Jashtëzakonshme, dhe nëse kërkohet, Operatori i Energjisë së Ripërtërishme duhet të ofrojë menjëherë Rregullatorit çdo informacion ose shpjegim të mëtejshëm të kërkuar.



- 7 Rregullatori duhet të njoftojë Operatorin e Energjisë së Ripërtërishme brenda 20 ditëve pune nga marrja e Raportit të Ndikimit Financiar nëse e miraton apo jo Përshtatjen e Jashtëzakonshme të propozuar nga Operatori i Energjisë së Ripërtërishme. Rregullatori duhet ta miratojë propozimin nëse ai:
 - 7.1 Përbushë kushtet e përcaktuara më sipër;
 - 7.2 Është llogaritur saktë; dhe
 - 7.3 Merr në konsideratë të gjitha informacionet materiale që janë të disponueshme në mënyrë të arsyeshme në atë kohë.
- 8 Nëse Rregullatori miraton Përshtatjen e Jashtëzakonshme të propozuar, ai duhet të publikojë ndryshimin e propozuar të Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme për konsultim publik brenda 10 Ditëve Pune para këtij miratimi.
- 9 Nëse Rregullatori nuk e pranon propozimin e Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme, duhet të ofrojë arsye dhe dëshmi për mospranim, në përputhje me këtë Rregull, dhe të publikojë llogaritjen e vet të Fondit Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme.
- 10 Rregullatori duhet të miratojë Fondin e ri Mbështetës të Energjisë së Ripërtërishme dhe Detyrimin për Energji të Ripërtërishme brenda 20 ditëve pune nga publikimi i tij për konsultim publik.



SHTOJCA 4 KOMPENSIMI PËR PAGESAT E VETË-KONSUMATORËVE TË ENERGJISË SË RIPËRTËRISHME

- 1 Operatori i Energjisë së Ripërtërishme duhet të kompensojë furnizuesit për kreditë e shpenzuara të Vetë-konsumatorëve të tyre të Energjisë së Ripërtërishme.
- 2 Për Vetë-konsumatorët e Energjisë së Ripërtërishme të mbështetur sipas skemës së matjes neto, Operatori i Energjisë së Ripërtërishme duhet të kompensojë furnizuesit për të gjitha kreditë e shpenzuara (kWh) nga Vetë-konsumatorët e tyre të Energjisë së Ripërtërishme sipas formulës së mëposhtme:

$$C_{pro_{nm}}^s = RC_{nm} * WARP_{nm}$$

$C_{pro_{nm}}^s$ Kompensim ndaj Furnizuesit për pagesat e Vetë-konsumatorëve të Energjisë së Ripërtërishme me matje neto.

RC_{nm} Kreditë të shpenzuara (në kWh) nga Vetë-Konsumatorë të Energjisë së Ripërtërishme të mbështetur përmes skemës së matjes neto brenda muajit të kaluar.

$WARP_{nm}$ Çmimi Mesatar i Ponderuar me Pakicë i Vetë-konsumatorëve të Energjisë së Ripërtërishme të mbështetur përmes skemës së matjes neto, bazuar në shumën (në kWh) të kredive të shpenzuara.

- 3 Për Vetë-konsumatorët e Energjisë së Ripërtërishme të mbështetur sipas skemës së faturimit neto, Operatori i Energjisë së Ripërtërishme duhet të kompensojë furnizuesit për të gjitha kreditë monetare të shpenzuara (€) nga Vetë-konsumatorët e tyre.
- 4 Çdo furnizues së bashku me informacionin dhe të dhënat në Neni 5, do të dërgojë një faturë mujore Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme për kompensimin e kredive të shpenzuara nga Vetë-Konsumatorët e Energjisë së Ripërtërishme.